

HISTORIKU I SHKOLLËS

Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan është vazhdimësi e shkollës së mesme bujqësore, gjimnazit, shkollës teknike dhe QAMO-s.

Arsimi i mesëm në komunën e Lipjanit daton nga viti shkollor 1960/61, kur me vendimin e Këshillit Popullor të Komunës së Lipjanit të marruar më 23 dhjetor formohet një paralele për punëtor të kualifikuar të veprimtarisë bujqësore. Kjo është numëruar si shkollë e ulët dyvjeçare. Shkolla e Mesme Bujqësore është themeluar në vitin shkollor 1962/1963 me vendimin e Këshillit Popullor të komunës së Lipjanit dhe pëlqimin e Sekretariatit Krahinor të Arsimit dhe Kulturës në kuadrin e shkollës së Mesme Bujqësore edhe më tej ka funksionuar shkolla e ulët dyvjeçare, e cila u suprimua në vitin shkollor 1963/64. Shkolla Bujqësore në fillim ka pasur tri profile arsimore: lavërtari, blegtori dhe makineri. Mësimi është zhvilluar vetëm në gjuhën serbo-kroate. Karakteristikë e kësaj periudhe të shkollimit është se në kuadrin e paraleleve me mësim në gjuhën serbo-kroate kanë mësuar edhe nxënësit shqiptarë, të cilët shtesë e kanë pasur lëndën e gjuhës shqipe. Lëndën e gjuhës shqipe e kanë organizuar arsimtarët Hilmi Rakovica dhe Beqir Peqani.

Për shkak të numrit të madh të nxënësve shqiptarë, nevojave për arsimim në gjuhën amtare shqipe dhe kërkesave të prindërve, Kuvendi komunal në Lipjan në vitin 1968 ka marrë vendim për hapjen e gjimnazit. Në gjimnaz janë formuar dy paralele me mësim në gjuhën shqipe dhe dy serbokroate. Gjimnazi i ka pasur 70 nxënës shqiptarë dhe 69 nxënës serbë e malazez.

Shkolla bujqësore në vitin 1970 është shndërruar në shkollë teknike me profile të shkollës bujqësore dhe makinerike.

Në vitin 1974 janë bërë ndryshime të mëdha shoqërore, është aprovuar Kushtetuta dhe janë bërë përgatitje për ndryshimin e ligjit mbi arsimin e mesëm.

Me aprovimin e ligjit mbi arsimin e mesëm të orientuar në vitin 1976 u bë reforma edhe në arsimin e mesëm të Lipjanit.

Në vitin shkollor 1976/77 u bë fuzionimi i shkollës Teknike dhe Gjimnazit. Me fuzionimin e këtyre dy shkollave dhe regjistrimin e nxënësve në vitin e parë të arsimit të mesëm të orientuar u themelua Qendra e Arsimit të Mesëm të Orientuar. QAMO u themelua me vendimin e Sekretariatit Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Në kohën e themelimit QAMO ishte e përbërë nga katër njësi:

- Gjimnazi
- Shkolla Teknike
- Arsimi i Orientuar-klasa-1
- Shërbimet e përbashkëta dhe ekonomia.

Në vitin shkollor 1978/80 doli gjenerata e parë e nxënësve që janë shkolluar sipas ligjit dhe sistemit shkollor të vitit 1976.

Në vitin 1986 përsëri u bë reforma në planet dhe programet mësimore dhe u aprovua një ligj i ri mbi arsimin dhe edukimin e Mesëm të Orientuar. Sipas këtij ligji u bë reduktimi i degëve dhe profileve arsimore nga 23 degë në 18 degë. Orientimi i nxënësve në degë dhe profile arsimore,

tash bëhet nga klasa e parë e jo nga klasa e tretë. Kjo mënyrë e shkollimit vazhdoi deri në janar të vitit 1990, kur Kuvendi i Serbisë pa dëshirën e e popullit shqiptarë, aprovoi ligjin famëkeq mbi arsimin e mesëm sipas të cilit bëhet segregacioni në arsim. Arsimtarët shqiptarë në Kosovë sipas këtij ligji janë të obliguar që administratën në librin e klasës ta bëjnë në dy gjuhët. Ligji i obligon nxënësit shqiptarë që të mësojnë gjuhën serbe dhe ç'është kryesore bëhen ndryshime të mëdha në planet dhe programet mësimore, duke heqë nga çdo njësi mësimore e cila në vete përmbante vlera pozitive, shpirtërore e materiale të gjuhës e historisë sonë kombëtare.

Shqiptarët, këtë ligj nuk e pranuan dhe kështu kundërshtimet filluan të ashpërsohen në marrëdhëniet ndërmjet arsimtarëve shqiptarë e serbë.

Më 26 qershor të vitit 1990 Kuvendi i atëhershëm i Kosovës aprovoi "Rrjetin e shkollave të mesme". Sipas këtij dokumenti Lipjanit i caktohen tri shkolla të mesme: Gjimnazi shkollë e arsimit të përgjithshëm, Shkolla Ekonomike Bujqësore dhe Shkolla Teknike. Viti shkollor 1990/91 fillon me probleme të mëdha dhe me segregacion të plotë të nxënësve dhe arsimtarëve shqiptarë dhe serbë. Duke parë qëndrimin dinjitoz të nxënësve dhe arsimtarëve shqiptarë që të mbijetojnë të gjitha pengesat që i ushtronte pushteti, Kuvendi i atëhershëm i Serbisë më 26 nëntor 1990 merr vendim që shkolla e mesme "Ulpiana" në Lipjan të vihet në masa të dhunshme. Me këtë vendim për shqiptarët, suprimohen të gjitha të drejtat e këtij institucioni shkollor. Zbatimi i këtyre masave realizohet me 4 dhjetor të vitit 1990, kur pushteti serb, largoi me dhunë drejtorin e shkollës Ruzhdi Hajdini dhe në vend të tij emërohet drejtor i nacionalitetit serb.

Nga ky moment fillon edhe maltretimi i punëtorëve shqiptarë nga ana e drejtorit serb. Kjo situatë zgjatë deri më 1 mars 1991 kur nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë dëbohen me dhunë nga objekti shkollor legjitim. Menjëherë pas dëbimit, Këshilli i arsimtarëve të shkollës mori vendim që procesi mësimor të mbahet nëpër oda private. Kështu për shkak të ruajtjes së kontinuitetit të procesit të mësimdhënies dhe vitit mësimor në qershor të vitit 1991 në fshatin Gadime u organizuan provimet e klasës për të gjithë nxënësit e shkollës. (me vendim të organeve krahinore të arsimit).

Viti shkollor 1991/92 filloi me mjaftë peripeci më 21 janar të vitit 1992 procesi mësimor u zhvillua në 21 punkte mësimore me mbi 400 oda private. Procesi mësimor u organizua sipas variantit C (mësimi konsultativ). Në gjysmëvjetorin e parë u organizua mësimdhënia për lëndët e përgjithshme, ndërsa në gjysmëvjetorin e dytë u organizua procesi i mësimdhënies për lëndët profesionale.

Kjo formë e mësimin vazhdoi deri në qershor të vitit 1999 kur Kosova u çlirua dhe nxënësit tanë u kthyen në qendrën amë në Lipjan, pikërisht më 22 qershor të vitit 1999 një grup mësimdhënësish prej 5 vetash (Adil Rashiti, Islam Sllamniku, Isa Rashiti dhe Feriz Rexhepi) e thyen derën e zyrës së drejtorit dhe hynë në objektin e tyre legjitim shkollor. Prej kësaj ditë të gjithë arsimtarët paraqiteshin në punë për çdo ditë. Kështu filloi një periudhë e re në arsimin kosovarë e me këtë edhe në arsimin e komunës së Lipjanit. Shkolla e Mesme "Ulpiana" si institucion edukativo-arsimor me këtë emër është themeluar më 10 qershor të vitit 1994 me vendim të ministrisë së atëhershme të arsimit.

Kjo formë e organizimit të mësimet vazhdoi deri në vitin 2003 ku shkollimi i mesëm në Lipjan u nda në dy shkolla: në shkollën e mesme profesionale ku u emërua me emrin “Adem Gllavica” dhe në Gjinnaz me emrin që trashëgoi “Ulpiana”. Në kuadër të gjinnazit “Ulpiana” gjendet dhe funksionon paralelja e ndarë fizike në Gadime dhe paralelja e ndarë fizike në Shalë e cila në vitin 2008 kjo paralele ndahet dhe pavarësohet si shkollë e mesme “Mikse”.